

rrugë dhe sipër. E ngiste veturën e tipit *Ford Eskort*, e cila u gjet pas dy ditësh në Rahovec/Orahovac. Për një kohë të gjatë, familjarët nuk dinin asgjë për fatin e tij. Mbetjet mortore të Svetozarit u zhvarrosën në varrezat e Dragodanit në Prishtinë/Priština. Në datën 1.12.2006, familjarët i kanë varrosur ato në varrezat Orlovaça në Beograd.

Burimet: deklarata D.K, M.K, FDH-592; OMPE, *Mbetjet...*, FDH-15297; AFPRRZHKëM, *Registri i personave...*, FDH-16116; AIS, *Zona...*, 53,57, FDH-16913; USCG KGDH, *Registri...*, FDH-8817.

Abdullah (Zijadin) Bugari

(6.06.1962, shqiptar nga Rahovec/Orahovac, punëtor, tre fëmije, pjesëtar i UÇK-së)

Abdullahu punonte në depon e ndërmarrjes *I Maji* në **Rahovec/Orahovac**. I ati i punonte si receptionist në Shtëpinë e Shëndetit. Në fund të vitit 1997, Abdullahu aderoi në radhët e UÇK-s. Gjatë sulmit mbi qytetin e Rahovecit/Orahovac, më 17.07.1998, Abdullahu kishte për detyrë që të merrte pjesë në sulmin ndaj Shtëpisë së Shëndetit. Një ditë më vonë, [18.07.1998], ai u nis në aksion të bastisjes së banesave serbe dhe konfiskimit të armëve, në ndërtesën që gjendet në afërsi të Shtëpisë së Shëndetit. Në njërën nga banesat, Abdullahu gjeti vdekjen. Pas rivendosjes së kontrollit mbi qytet më 19.07.1998, policia e ka gjetur trupin e tij të pajetë në rrugë. Abdullahun e kanë varrosur në varrezat e Prizrenit/Prizren. Pas përfundimit të luftës, më 17.08.1999, familjarët dhe UÇK-ja i kanë rivarrosur mbetjet e tij mortore në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Rahovec/Orahovac.

Burimet: deklarata N.G, FDH-465; deklarata J.S, FDH-3899; deklarata V.M, FDH-5693; deklarata S.M, FDH-20101; deklarata Z.B, FDH-32456; SHFĐUÇK, *Feniksët...6*, 11-16; J. Martinsen, *Registri...*, FDH-26092; *Rahovec in Flames and Smoke Amidst Continued Serb Shelling*, pasqyra e lajmeve, KIC, 21.07.1998, FDH-29372.

Aleksandar (Gradimir)

Majmarević-Acko

(29.05.1971, serb nga Rahovec/Orahovac, punëtor)

Ditën e premte, më 17.07.1998, kur forcat e UÇK-së depërtuan në qytet, banorët e lagjes serbe e organizuan mbrojtjen. E mbanin rojën te objekte të rëndësishme. Të shtunën, më 18.07.1998, Aleksandar, i cili ishte i armatosur me pushkë, mbante rojën te baseni nga i cili qyteti [Rahoveci/Orahovac] furnizohej me ujë. Përndryshe, ai ishte i punësuar në ndërmarrjen komunale të qytetit. E kanë vrarë me pushkë snajperi nga ora 16:00, pranë shtëpisë së Siniša Vitoševićit. Kur ra terri i natës, Siniša dhe Žika Milenković e larguan trupin e tij nga rruga. Një ditë më vonë, familjarët e kanë varrosur Aleksandrin në portën e kishës ortodokse në Rahovec/Orahovac.

Burimet: deklarata S.K, FDH-401; deklarata S.M, FDH-423; deklarata S.K, FDH-464; deklarata V.A, FDH-465; deklarata R.M, FDH-5689; deklarata Z.G, FDH-5694; deklarata Z.G, FDH-18940; deklarata A.A, FDH-25563; deklarata V.M, FDH-36438; USCG KGDH, *Registri...*, FDH-8817; KKMKRF, *Personat...*, FDH-10832.

Sreten (Stanoje) Simić-Srećko

(10.12.1931, serb nga Optrusha/Optëruša, komuna e Rahovecit/Orahovac, bujk, pesë fëmijë)

Božidar (Sava) Božanić-Boško

(13.07.1939, serb nga Optrusha/Optëruša, komuna e Rahovecit/Orahovac, bujk, katër fëmijë)

Novica (Božidar) Božanić

(5.09.1966, serb nga Optrusha/Optëruša, komuna e Rahovecit/Orahovac, punëtor në plantacionet e KIB Orvin, tre fëmijë)

Mladen (Obrad) Božanić

(25.02.1949, serb nga Optrusha/Optëruša, komuna e Rahovecit/Orahovac, arsimtar, tre fëmijë)

Nemanja (Mladen) Božanić

(5.05.1982, serb nga Optrusha/Optëruša, komuna e Rahovecit/Orahovac, nxënësi)

Spasoje (Milan) Banzić

(16.05.1951, serb nga Optrusha/Optëruša, komuna e Rahovecit/Orahovac, bujk, pesë fëmijë)